

LIGJ
Nr. 149/2020

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 96/2016, “PËR STATUSIN E GJYQTARËVE
DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË:

VENDOSI:

Në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet shtesa e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 91, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Relatori përcakton dhomën dhe seksionin ku magjistrati ka ushtruar funksionin në periudhën për të cilën bëhet vlerësimi dhe, në varësi të numrit të çështjeve për çdo kategori, përcakton numrin e çështjeve që do të përzgjidhen në mënyrë të barabartë për secilën kategori, duke përfshirë domosdoshmërisht çështjet penale që lidhen me veprat penale të parashikuara në kreun X, të Kodit Penal, për të cilat parashikohet dënimi në minimum jo më pak se një vit burgim, nëse magjistrati ka hetuar/gjykuar çështje të kësaj natyre gjatë periudhës së vlerësimit.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.12.2020

**Shpallur me dekretin nr. 11907, datë 8.1.2021 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta**